

Emri i Lëndës : Menaxhimi dhe Udhëheqja e Klasës							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
PSP 675	A	Vjeshtë	1.00	1.00	0.00	1.50	3.00
Lektori		Enriketa Sogutlu, Prof. Asoc. Dr.					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Formim i Vazhduar					
Përshkrimi		Kursi i njeh studentët me një qasje të integruar për menaxhimin e klasës dhe sjelljeve të ndryshme individuale dhe në grup. Studentët njihen me strategji që krijojnë një klimë pozitive që promovon angazhimin e nxënësve, mendimin kritik, dhe gjithë përfshirjen. Studentët kuptojnë rolin dhe ndikimin e familjes dhe të prindërve në sjelljen e nxënësve në shkollë.					
Objektivat		Qëllimi i këtij kursi është t'i pajisë studentët me njohuri teorike dhe praktike mbi menaxhimin dhe udhëheqjen e klasës. Studentët do të njihen me problemet kryesore në klasë dhe strategjitë për t'u përballur me to. Studentët nxisin të nxënit nëpërmjet menaxhimit të klasës me efektivitet. Studentët zhvillojnë një sistem menaxhimi të klasës bazuar në mbështetje dhe ndërhyrje pozitive					
Konceptet Kryesore		1. Menaxhim i klasës dhe ndërhyrja 2. Klima pozitive 3.Rregullat dhe disiplina 4.Gjendja emocionale 5. Vlerësimi 6. Konflikti dhe zgjidhja					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Marrëdhëniet mësues-nxënës Lidhja me studentët dhe rëndësia e besimit të ndërsjellë. Pranimi pa kushte i çdo nxënësi dhe e potencialit që ata kanë për të mësuar. Ndikimi i këtij pranimi në krijimin e besimit të ndërsjellë. Të gjithë këta faktorë krijojnë një mjedis që ofron mbështetje emocionale dhe zhvillim të mendimit kritik dhe e nxisin nxënësin të eksplorojë për dije edhe jashtë shkollës.						
2	Roli i mësuesit si lider Një mësues-lider i mirë duhet të fitojë besimin e nxënësve. Njohja me katër llojet e ndryshme të lidhshimit: lidhshim ekspert, lidhshim referent, lidhshim legjitim, lidhshim shpërblye. Lidhshim ekspert dhe lidhshimi referent si dy rolet që mësuesi duhet të përpiqet t'i fitojë dhe mënyrat si arrihet kjo.						
3	Klasa dhe ndarja në grupe. Katër fazat e formimit të grupit: formimi, shpërthimi, normimi dhe kryerja, dhe ndikimi i tyre në menaxhimin e klasës dhe arritjen e objektivave.						
4	Qasje demokratike ndaj menaxhimit të klasës Rëndësia e organizimit të mbledhjeve të klasës, roli që marrin nxënësit si lider dhe mësuesi si pjesë e diskutimit. Mënyra për krijimin e një mjedisi efektiv që mundëson ndërveprim nxënës-mësues.Tre lloje mjedisi dhe mënyrat për krijimin e tyre: mjedisi social, mjedisi organizator dhe vendosja e rregullave dhe procedurave.						
5	Njohja me fushat problematike në klasë: monitorimi i nxënësve, realizimi i kalimeve në situata të ndryshme, rastet e ndërprerjes, dhe dhënia e detyrave. Mbyllja e orës së mësimit si element kyç për përmbledhjen e mësimit dhe vlerësimin e arritjes së objektivave.						
6	Menaxhimi i klasave me diversitet kulturor. Çfarë duhet pasur parasysh dhe si të promovohet pranimi i diversitetit. Planifikimi i ditës së parë si element kyç në menaxhimin e klasës: prezantimi, përgatitja e një veprimtarie hyrëse, vendosja e rregullave dhe pritshmërive, prezantimi i lëndës, dhe mbyllje e planifikuar e orës së parë.						
7	Klasa dhe shkolla- komunitet profesional i të nxënit. Analiza e një rasti konkret të menaxhimit të klasës, përmbledhje e termave dhe koncepteve të trajtuara, analizë e rezultateve të të nxënit për këtë pjesë të lëndës. Pyetje për diskutim dhe praktikë						
8	Prezantim projektsh						

9	Angazhimi i nxënësit- element kyç në menaxhimin e klasës. Tradita humaniste në menaxhimin e klasës, komunikimi bashkëpunues, teknika e strategji për ta arritur, roli pozitiv i të nxënit dhe mësuarit bashkëpunues në menaxhimin e klasës, startegji për zbatim sa më efikas.	
10	Analiza e sjelljes element i rëndësishëm për menaxhimin e klasës, menaxhimi i situatave të padëshiruara, ndërhyrja efikase dhe modifikimi i sjelljeve shqetësuese, menaxhimi i klasës sipas mënyrës tradicionale.	
11	Menaxhimi i klasës sipas një qasjeje të integruar, menaxhimi i klasave me profil të ulët dhe ballafaqimi me sjellje të vazhdueshme shqetësuese, reagimi ndaj sjelljeve negative.	
12	Përdorimi i shpërblimit dhe përforsimit për fitimin dhe shfaqjen e sjelljes së dëshiruar, mënyra alternative përkundrrejt ndëshkimit, analizë e rasteve konkrete.	
13	Roli dhe ndikimi i familjes në sjelljen e nxënësit në klasë dhe në shkollë, nevoja e takimit me prindër ose familjarë, elementë që duhen pasur parasysh në takimin me prindër, organizimi, zbatimi dhe vlerësimi i takimit me prindër, roli i përfshirjes së prindërve në arritjet dhe sjelljen e nxënësit, tema dhe çështje që duhen pasur parasysh në takimet individuale me prindër: probleme më mësimin dhe sjelljen, neglizhimi ose abuzimi me fëmijën, bullizimi dhe dhuna.	
14	Menaxhimi i klasave shumëkulturore, studim dhe analizë rastesh, përmbledhje e termave dhe rezultateve të të nxënit, pyetje për diskutim dhe praktikë.	
15	Përmbledhje e lëndës, diskutimi rezultateve të të nxënit, dhe arritjes së objektivave	
16	Final Exam	
Parakushtet		Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura		• Borich, G. D. (20178). Effective teaching methods. Pearson Education
Referenca të tjera		• Musai, B. (2003). Metodologji e mësimdhënies. Albgraf, Tiranë
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat		
1	Studenti njeh strategji dhe praktika për menaxhimin e klasës	
2	Studenti përdor strategji dhe praktika për menaxhimin e klasës dhe të sjelljeve të ndryshme	
3	Studenti krijon një klimë pozitive me anë të strategjive gjithëpërfshirëse	
4	Studenti përdor qasje integruese për adresimin e nevojave dhe emocioneve të nxënësve.	
5	Studenti bashkëpunon me drejtuesit e shkollës dhe familjen për raste specifike	
6	Studenti përdor teknika për trajtimin dhe ndërhyrje në raste problematike	

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	35	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	20	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			55
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			45
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	2	32
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	1	3	3
Gjysmë finale	1	5	5
Provimi final	1	7	7
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			75
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			3.00
ECTS			3.00